



Shërbimet për Nxënësit me Paaftësi gjatë Vitit të Zgjatur Mësimor (ESY)

Çfarë është ESY? Shërbimet për Vitin e Zgjatur Mësimor (ESY) janë shërbime të edukimit special, që ofrohen falas për nxënësit me paaftësi përtej 180 ditëve mësimore të një viti mësimor të rregullt. Qëllimi parësor i ESY është të ruaj progresin e bërë gjatë vitit të rregullt mësimor në synimet dhe objektivat kryesore të nxënësit. Programi i ESY bazohet në nevojat individuale të nxënësit dhe zakonisht nuk përfshin të gjitha synimet dhe objektivat në IEP e nxënësit.

Si përcaktohet pjesëmarrja dhe shërbimet në ESY? Nevoja e nxënësit për ESY dhe shërbimet ESY të nevojshme duhet të diskutohen në takimin e Ekipit të IEP. Sasia, lloji dhe zgjatja e shërbimeve, që miratohen gjatë ESY do të varen nga nevojat individuale të nxënësit dhe përcaktohen nga ekipi i IEP bazuar në të dhënat e aftësive dhe sjelljeve të nxënësit. ESY mund të përfshijë jo vetëm edukimin special, por mundet gjithashtu të përfshijë edhe shërbime të tjera të tilla si terapia profesionale, terapia fizike dhe terapia e të folurit.

Ku dhe Kur veprohet me ESY? Shërbimet e ESY përgjithësisht do të ofrohen në ndërtesat e Drejtorisë Arsimore ditëve të Marta, të Mërkura dhe të Enjte, në orët 9:00 a.m. deri 1:00 p.m., për një periudhë 6-javë, në stinën e Verës. Megjithatë, nuk ka një numër, lloj, ose vazhdim të caktuar të shërbimeve ESY; shërbimet për çdo nxënës përcaktohen nga nevojat individuale, që të garantojnë edukimin e duhur sipas nevojave të tij/saj. Ju duhet të diskutoni gjatë takimeve të Ekipit të IEP nëse nxënësi kërkon më pak, më shumë, ose shërbime të tjera alternative.

Çfarë duhet të bëni nëse keni pyetje në lidhje me ESY ose kërkonti një takim të IEP, ku të diskutoni ESY? Nëse, në një moment ju keni pyetje, ose dëshironi të diskutoni për ESY e nxënësit, ju mund të kërkonti një takim të IEP. Rrugët për të kërkuar një takim të IEP për të diskutuar ESY e nxënësit, janë si më poshtë:

Opsioni 1: telefononi ose dërgoni email mësuesit të Edukimit Special, në shkollën e nxënësit,

dhe/ose

Opsioni 2: telefononi ose dërgoni email Koordinatorit të Edukimit Special, në shkollën e nxënësit.